

Nr. 1097/1
19.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 537/1 prot.

Gjirokastrë, më 16.06.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 40, datë 28.5.2026, “Për miratimin e raportit të monitorimit dhe vlerësimit të buxhetit për periudhën 4-mujore të viti 2026”, konfirmohet.
2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 41, datë 28.5.2026, “Për disa ndryshime në VKB nr. 77, datë 22.12.2025, ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2026’”, konfirmohet.
3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 42, datë 28.5.2026, “Për miratimin e dhënies ndihmë financiare personave për dëmin e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, zjarri”, nuk konfirmohet. Vendimi i këshillit bie në kundërshtim me pikën 3.1, gërma ‘a’, të VKM nr. 414, datë 8.7.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, si dhe të kreut III, të VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ku përcaktohet se në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, akordimi i ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i mbrojtjes civile jepet vetëm për objektet e banimit.
4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 43, datë 28.5.2026, “Për miratimin e dhënies ndihmë financiare personave për dëmin e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, përmbytjet”, nuk konfirmohet. Vendimi i këshillit bie në kundërshtim me pikën 3.1, gërma ‘a’, të VKM nr. 414, datë 8.7.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, si dhe të kreut III, të VKM nr. 329, datë

16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ku përcaktohet se në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, akordimi i ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i mbrojtjes civile jepet vetëm për objektet e banimit.

5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 44, datë 28.5.2026, “Për anullimin e vendimit të këshillit bashkiak nr. 11, datë 29.01.2026, ‘Për caktimin e masës së shpërblimit shtesë për kryetarin e Këshillit Bashkiak Tepelenë”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’” nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 45, datë 28.5.2026, “Për miratimin e shpërblimit shtesë të kryetarit të Këshillit Bashkiak Tepelenë”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’” nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

